



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 54 Datë 23.06.08

PËR

Për miratimin e fondit për implementimin e projektit “Simpoziumi Ndërkombëtar – Skulptura e Parkut” qershor-korrik 2008.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret për miratimin e fondit për implementimin e projektit “Simpoziumi Ndërkombëtar – Skulptura e Parkut” qershor-korrik 2008, Ne zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika “dh”, ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 “Për buxhetin lokal”, Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008”, Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrise së Brendshme “Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008”, si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit total prej 600 000 lekë për implementimin e projektit “Simpoziumi Ndërkombëtar – Skulptura e Parkut” qershor-korrik 2008
2. Ky fond do të perballohet nga fondi i çelur për blerje pajisje (gjenerator) për bibliotekën me këtë strukturë buxhetore:

Pakesohet	00	08250	05	Art	2310000	- 600.000 (Biblioteka)
Shtohet	00	08250	05	Art	6020000	+ 600.000 (Qendra Ekonomike e Kulturës)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret dhe Qendra Kulturore “Vangjush Mio”.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit
Raimonda Nase
Raimonda NASE